

4. BUJQËSIA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Bujqësia edhe në të kaluarën edhe sot ka rol të rëndësishëm në ekonominë e Maqedonisë. Në vitin 1948 72% e popullsisë merrej me bujqësi. Në vitet e mëvonshme numri i popullsisë bujqësore gradualisht bie dhe sot është rreth 10% nga popullsia merret me bujqësi, por prapëseprapë, ajo pjesëmarrje është ende relative e madhe. Vulën e përgjithshme që e bartë bujqësia jonë është prapambeturia e përgjithshme që manifestohet si përmes rendimenteve të ulëta për njësi sipërfaqe dhe për një frymë kafshë shtëpiake, ashtu edhe në prodhimin dhe produktivitetin përgjithshëm të ulët. Prapambeturia më së shumti shihet përmes faktit që popullsia aktive në bujqësi nuk është në gjendje ta ushqej popullsinë tjetër, për çka një pjesë nga nevojat në krejt periudhën e pasluftës mbulohet me eksport. Për, shembull, nevojat e Republikës nga gruri arrijnë rreth 300.000 tonë, kurse në vit mezi mbledhen 150.000 tonë. E ngjashme është gjendja edhe me mishin i cili, për shembull i lopës, në vit konsumohet nga 18.000 tonë, kurse prodhohen vetëm 9.000 tonë, tjetra importohet.

Pozita ekonomike në bujqësi gjatë kohë nuk ka qenë në nivelin e kënaqshëm, kurse viteve të fundit edhe ndishëm e keqësuar. Numri i madh i të aftëve për punë e ka lëshuar bujqësinë, që ka sjellë deri te dukuria e amvisëri të vjetruar të pa aftë për punë dhe mungesa sezonale e fuqisë së punës.

Gjendja e shumtë, fuqia konsumuese dhe përhapja e popullsisë janë faktorët e rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë. Për dallim nga prodhimi industrial që zhvillohet kryesisht në qendra të caktuara, prodhimtaria bujqësore zhvillohet gati nëpër të gjithë territorin e Republikës. Përhapja e këtillë është në lidhje të ngushtë me nevojat për shfrytëzimin e tokës si mjetë themelor për këtë lloj prodhimi. Me këtë rast, kushtet dhe resurse natyrore për bujqësinë si sektor e aktiviteti primar ekonomik kanë rëndësi të madhe, ndërsa në raste të caktuara edhe vendimtare. Si bazë e prodhimit bujqësor, fondi i tokës së Republikës është mjaftë i kufizuar dhe ai lajmërohet si determinantë për zhvillimin e bujqësisë. Gjithashtu edhe imtësimi paraqitet si faktorë kufizues për zmadhimin për prodhimin agrarë.

Industria, gjithashtu, ka ndikim të vetë në zhvillimin e bujqësisë. Para se gjithash, ajo është përcjellës i domosdoshëm i prodhimeve bujqësore, zhvillohet paralelisht me të ose në raste të caktuara i paraprinë, dhe në këtë mënyrë e specializon dhe intensifikon. Për shembull, industria e konservimit mundëson zgjerimin e prodhimit të kulturave kopshtare dhe pemëve edhe në ato regjione që janë gjeografikisht të larguar nga qendrat konsumuese. Industria e përpunimit të mishit e nxitë zhvillimin e blegtorisë etj.



Peizazh agrar në Pellagoni. Ndarja në numrin e madh të parcelave të vogla paraqet faktorë kufizues për zhvillimin e bujqësisë.

Kurse në zhvillimi i bujqësisë rëndësi të theksuar ka edhe politika ekonomike. Ajo me rolin e saj orientues dhe investimet e përcakton përhapjen e prodhimeve bujqësore, ndikon mbi specializimin dhe regjionalizimin e atij prodhimi etj.

Fondi i tokës paraqet bazën për prodhimet bujqësore. Nga territori i përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë, sipërfaqet bujqësore përfshijnë 1.236.000 he ose 48%. Kjo përqindje është më e ulët se sa një varg vendesh në Evropë. Sipas kësaj, baza për prodhimet bujqësore, shikuar përmes fondit të tokës në Maqedoni është mjaftë i kufizuar.

Masat për përparimin bujqësisë. Kushtet natyrore në Maqedoni mundësojnë prodhimin e llojllojshëm bujqësor. Për shfrytëzimin e tyre racional, kurse me qëllim të përsosjes dhe përparimit të bujqësisë dhe zmadhimit e riprodhimit bujqësor merren një varg masash. Ndërmjet tyre veçmas janë të rëndësishme: organizimi i territorit bujqësor nga aspekti i bujqësisë, marrja e masave agroteknike për përparimin e bujqësisë, seleksionimin e farave, materialin mbjellës, dhe kafshët shtëpiake të fisnikëruara, mbrojtjen veterinarë dhe tjetër, kuadri profesional, etj.

Në grupin e masave agroteknike bëjnë pjesë: masat meliorative, agromekanimizimi, agrokimizimi, seleksionimi i farave, rajonizimi etj.

Masat meliorative i përfshijnë të gjitha aktivitetet që janë drejtuar nga shfrytëzimi më efikas i tokës bujqësore. Te ne deri tani janë kryer llojet vijuese të melioracioneve: 1. Tharja dhe ujitja hidroteknike; 2. Pastrimi kulturo-technik i barojave

të tokës, rrafshimit dhe trazimet të sipërfaqeve dhe 3. Melioracionet agroteknike - përmirësimi të tokës me klasifikim, mumifikim dhe luftën kundër erozionit.

Melioracionet hidroteknike i përfshinë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me tharjen dhe ujitjen e tokës. Në vitin 2000 në Maqedoni ishte tharë sipërfaqja e përgjithshme prej 98.000 ha. Vlerësohet se sipërfaqet e përshtatshme për tharje në Republikë janë rreth 420.000 ha, kurse të njëjtin vit gjithsej sipërfaqe ishte shtetur prej 45.000 ha. që tregon se nuk është e mjaftueshme.

Agromekanizimi paraqet njërin prej kushteve themelore për bukësin e përparuar. Edhe pse me përdorimin e makinerisë bujqësore, toka përpunohet në mënyrë më kualitative dhe me më pak numër të punëtorëve, kurse realizohen më shumë rendimente, megjithatë në bujqësinë tonë ende përdoret edhe parmenda e drurit dhe një varg i veglave tradicionale bujqësore.



Parmenda e drurit, tërfurku dhe grabuja, vegla të vjetra bujqësore nga f. Rusinovë-Berovë. Sot të gjitha janë ende aktive dhe përdoren në përpunimin e tokës, sidomos në regjionet kodrinor dhe malorë të Maqedonisë.



Korja me kombajnë në Ovçe Pole. Makineria është gjithnjë e më shumë prezente në fushat tona.

Kimizimi i përfshin masat për përmirësimin e pjellorisë së tokës me përdorimin e plehrave artificialë, mbrojtjen e bimëve nga dëmtuesit dhe sëmundjet, si dhe mbrojtja e kafshëve shtëpiake nga sëmundjet e ndryshme. Shpenzimi i plehrave artificial është në rritje të vazhdueshme, por kjo ende nuk është e mjaftueshme. Sot në sipërfaqet e punueshme të vendin tonë shpenzohen rreth 60.000 tonë lloje të ndryshme të plehrave artificial.

Rajonizimi paraqet, gjithashtu, masë e rëndësishme për përparimin e bujqësisë. Me të, kurse në varshmëri nga kushtet natyrore, në Maqedoni ndahen 6 rajone të bujqësisë në të cilat kultivohet lloje të caktuara të kulturave të agrikulturës, kopshtarisë, kultivimin e vreshtarisë ose lloje të kafshëve shtëpiake.

Në atë pikëpamje në Maqedoni sipas hulumtimeve të deritanishme janë ndarë gjashtë rajone të bujqësisë: rajoni Mediteran (në të cilin janë përfshirë: i Gjevgjeli, Vallandovës, Strumicës, Radovishit, Negotinës, Kavadarit, Shtipit, Koçanës, Vinicës, Cv. Nikolës dhe Velesit); Pellagonis (i Manastirit, Prilepit, Demir Hisarit dhe Krushevës); Shkupit-Kumanovës (i Shkupit dhe Kumanovës): Regjioni perëndimor (Pollogu, Dibrës, Kërçovës dhe Poreçit); Rajoni Lindor Malishevës, Pijaneçës dhe Sllavishës) dhe rajoni i Liqeneve të mëdhenj fushëgropa e Ohrit-Strugës dhe Prespës).

PYETJE DHE DETYRA:

- ▶ Cilët faktorë më së shumti ndikojnë mbi zhvillimin e bujqësisë në R, e Maqedonisë?
- ▶ Cilat masa janë ndërmarrë në vendin tonë për përparimin e bujqësisë?
- ▶ Në sa rajone të bujqësisë është ndarë Maqedonia dhe cilat janë ato?

4.1. AGRIKULTURA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Agrikultura i përfshinë prodhimet e drithërave, industriale, kopshtare dhe kulturat foragjere. Sipas sasisë së prodhimeve ajo është fusha më e rëndësishme e bujqësisë, sepse përfshijnë më së shumti në sipërfaqet e përpunueshme, angazhon fuqi më të madhe punuese dhe pjesë të madhe të mjeteve agroteknike dhe siguron ekzistencë të pjesës më të madhe nga popullsia e fshatit. Megjithatë, sasi të kënaqshme për nevojat e konsumit në Maqedoni dhe për plasman në eksport japin vetëm kopshtarin nga kulturat industriale duhanin, kurse nga drithërat orizin. I pamjaftueshëm është i drithërave më të rëndësishme - grurin dhe misrin si dhe të kulturave industriale - panxharshegeri dhe lule dielli.

Në vitet e pasluftës në Maqedoni ndodhin ndryshime të rëndësishme në strukturën e sipërfaqeve të mbjelljeve. Llojlojshmëria e madhe nga kulturat agrikul-ture, që sot janë përfaqësuar në vendin tonë, është rezultat i faktorëve të ndryshëm klimatik, pedologjik dhe të tjerë që e kushtëzojnë kultivimin e tyre. Megjithatë, edhe përkundër përfaqësimit i numrit të madh të kulturave të ndryshme, si nga sipër-faqja, ashtu edhe për nga prodhimi, dominojnë kulturat e drithit. Ato agrikulturës i japin tipar të ekstenzivitetit dhe njëanshmërisë. Kulturat e drithit në vitin 2000 ishin mbjell në sipërfaqe prej 222.000 ha, ose përfshijnë 43% nga sipërfaqja e mbjella, ndërsa në periudhat e mëparshme përfaqësimi i tyre ishte edhe më i madh.

a) kulturat e drithit

Kushtet e volitshme klimatike mundësojnë në vendin tonë të kultivohen të gjitha llojet e kulturave të drithit, kurse posaçërisht gruri, elbi dhe orizin, dhe në masë më të madhe thekra dhe tërshëra. Sipërfaqja e përgjithshme e mbjell me drithë në vitin 2000 arrinte 222.000 ha nga e cila pjesa më e madhe ishte mbjell me grurë edhe atë 121.000 ha, kurse sipërfaqja më e vogël në tërshërë, vetëm 2.370 ha.

Gruri. Sipas madhësisë së sipërfaqes së ,mbjell ndërmjet kulturave të mb-jella ndërmjet kulturave të drithit, gruri është në vendin e parë. Në vitin 2000 me grurë ishin mbjellë gjithsejtë 121.000 ha që paraqet 54% nga përfaqësimi i të gjitha kulturave të drithit. Kjo është pasoj e faktit që gruri drithi më i rëndësishëm i bukës te ne. Kultivohet për shkak të kokrrës dhe kashtës. Kokrra paraqet interes i posaçëm për njeriun, sepse përdoret si bukë për ushqim, kurse kjo paraqet edhe lënda e parë e rëndësishme në industrinë e brumorëve - fidhe, makarona, shpagesë, keksëve, grisinave, ermik etj.

Kushtet e tokës janë shumë të rëndësishme për kultivimin e grurit. Ajo kërkon toka të pasura me materie ushqyese letë të afrueshme. Te ne mjaftë është e përhapur në fushëgropën e Pellagoni, Ovçe Pole, Tikveshit, Shkupit dhe fushëgropë të tjera.

Periudha vegjetuese e grurit është mjaftë e gjatë. Te ne, gruri i vjeshtës mb-jellët prej fillimit të tetorit deri te mesi i nëntorit, kurse koret në korrik, përkatësisht kjo periudhë zgjatë rreth 20 ditë. Sipas kohës së mbjelljes ajo ndahet në grurit vjesh-tor dhe pranveror.

Prodhimi i grunajave direkt është i varur nga madhësia e sipërfaqeve të mb-jella dhe rendimentit. Në vitin 2000 në Maqedoni janë prodhuar 300.000 tonë ose 2.470 kg për hektar. Rajon më i rëndësishëm për prodhimin e grurit është Pellagonia.

Misri. Misri paraqet kulturë shumë të rëndësishme. Para se gjithash, përdoret edhe për ushqimin e popullsisë, si dhe në industri.

Në të kaluarën, misrin te ne popullsia më shumë e përdorte për ushqim edhe atë veçmas në rajonet pasive, për çka është paraqitur edhe sëmundja pelagra. Sot

kryesisht përdoret për ushqimin e kafshëve shtëpiake dhe paraqet lëndën e parë të klasës së parë industriale. Nga misri në kombinim me prodhimet e tjera fitohen mbi 800 prodhime industriale për industrinë ushqimore, farmaceutike, kozmetike, kimike dhe degë të tjera të industrisë. Kështu, nga kokrra e misrit fitohen: amidin, vaj, sheqer, alkool, acidi i uthullës, acidi citron dhe prodhime të tjera. Për shkak të zbatimit të gjerë në blegtori dhe industri, misri është prodhim shumë i kërkuar si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në të jashtëmin, gjegjësisht luan rolë të rëndësishëm në tregti. Kultivohet në ato zona të cilat kanë mjaft nxehësi, dritë dhe lagështi të mjaftueshme, si dhe toka pjellore, të glinës.



Ara me misër në f. Shemshovë, Pollogu i Poshtëm. Në Fushëgropën e Pollogut misri gati rregullisht mbillet bashkë me groshën dhe misri shërben si mbështetës i saj. Në këtë mënyrë rendimente të shumta fitohen nga grosha dhe misri.

Më shumë misër në Maqedoni prodhohet në Fushëgropën e Pollogut. Në vitin 2000 gjithsejtë në Maqedoni prej 37.000 ha është prodhuar 125 tonë misër për ha.

Elbi. Në strukturën e sipërfaqeve me drithëra, ndërsa edhe sipas sasisë së prodhimit, në vendin tonë në vendin e tretë vjen elbi. Sipërfaqet me këtë drithë janë konstante dhe sillen rreth 50.000 ha. Elbi duron klimë si të ftohtë, ashtu edhe të

ngrohtë. Më pakë pëson nga thatësira dhe ka periudhë të shkurtër vegjetuese (rreth 100 ditë). Me këto karakteristika nuk ka qenë vështirë të përhapet nëpër të gjitha viset tona, ndërsa sidomos në ato me të reshura shiu të parëndësishme, siç janë rrethi i Tikveshit dhe Ovçe Poles, ku në masë të madhe e kompenson mungesën e prodhimit të misrit.

Elbi kultivohet për shkak të kokrrës dhe kashtës. Kokrra është e pasur me materie ushqyese në rendë të parë me amidon. Ajo ka zbatim të gjerë për përgatitjen e ushqimit të koncentruar për kafshët shtëpiake. Krahas kësaj, elbi përdoret edhe për ushqimin e njeriut, por buka prej elbi nuk ka kualitet të mirë. Kështu i përdoret elbi në viset e larta malore ku drithërat tjerë më pak kultivohen. Në industri elbi përdoret për fitimin e ermit, spiritusit, birës etj.

Thekra. Në krahasim me grurin, përfaqësimi i thekrës edhe në botë edhe te ne është mjaftë i vogël në rënie të vazhdueshme. Për te, megjithatë duhet të theksohet se është drithi më modest në krahasim me kushtet klimatike dhe tokësore. Ajo mundet të kultivohet edhe në lartësi mbidetare deri më 2.000 metra.

Thekra kultivohet për shkak të kokrrës dhe kashtës. Kokrra përdoret për industrinë ushqimore për prodhimin e bukës, e cila ka aromë karakteristike dhe përdoret për ushqimin e diabetëve. Nga kokrra fitohet edhe spiritusi. Krahas kokrrës, kashta ka rëndësi të posaçme. Popullsia nga viset kodrinoro malore me të madhe e përdorë për mbulimin e objekteve, për përpunimin e hasrave, për bërjen e litarëve, të ashtuquajturit lejtira për lidhjen e duajve, për ngrohje dhe qëllime të tjera. Mbjellët në sipërfaqe prej rreth 6.000 ha. Më e përhapur është në Malishevi dhe fushë-gropën e Sllavishës.

Orizi. Orizi është njëra prej kulturave të drithit më i përhapur në botë. rëndësi të veçantë ka për ushqimin e njerëzve në viset tropikale dhe monsunë ku vlerësohet si gruri në viset mesdhetare dhe veriore. Kokrra e orizit është e pasur me materie ushqyese që e bën të përshtatshme për ushqimin e njeriut . në industri prej saj fitohet amidoni dhe bëhen lloje të ndryshme të budingëve. Kashta e orizit përdoret në blegtori për ushqim dhe shtrirjen, në industri prej saj prodhohen letra më me kualitet, biku përdoret i material karburanti.

Prodhimi i orizit ka teknologji mjaftë të ndërlikuar, prej ndërtimit të rrjetit për ujitje, nëpërmjet përpunimit të tokës, dhe deri te korrja. Në Maqedoni përpunimi i tij ka traditë të gjatë dhe specificitete në prodhimin. Orizi në krahasim me drithërat e tjera ka edhe kërkesa specifike. Ato kërkesa kryesisht kanë të bëjnë me nxehtësinë dhe ujin. Ai mundet të kultivohet nëse gjatë 4-5 muajve gjatë vegjetacionit ka temperaturë mesatare ditore prej 20°C, pastaj kërkon edhe sasi të madhe të ujit, ngase duhet të ujitet gjatë krejt vegjetacionit.



Viset e parcelave me Oriz (te popullsia e njohur si gjolovi) në Fushën e Orizit - të Koçanës.

Parcelat e orizit domosdo çdoherë të jenë të mbushura me ujë i cili lëshohet që nga mbjellja dhe mbetet deri në fund të vegetacionit. Për shkak të kushteve specifike që i kërkon gjatë mbjelljes, në Maqedoni prodhohet vetëm në tri zona: Fushëgropën e Koçanës, Fushëgropën e Strumicës-Radovishit dhe Titovelesit. Më e përhapur është në fushëgropën e Koçanës, ku ekzistojnë kushte optimale për prodhimin tij.

PYETJE DHE DETYRA:

- ▶ Cilat kultura dominojnë në agrikulturën tonë dhe me sa hektarë janë përfaqësuar në vitin 2000?
- ▶ Sipas madhësisë së sipërfaqeve të mbjella në vitin 2000 gruri ishte në vendin e parë. Me sa hektarë ishte mbjellë ajo?
- ▶ pse elbi mbjellët nëpër krejt Maqedoninë dhe sa sipërfaqe mbjellën me te?
- ▶ Cilat kushte i kërkon orizi për kultivim dhe në cilat zona kultivohet në vendin tonë?

b) Kulturat industriale


Bimët industriale janë të përhapura nëpër të gjitha viset e vendit tonë. Megjithatë, edhe pse ka kushte të përshtatshme natyrore për kultivimin e këtij lloj bimësh, kushtet klimatike dhe pedologjike, ato nuk janë mjaftë të shfrytëzuara, ne nuk janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate. Kjo e vërteton faktin që si në të kaluarën, ashtu edhe sot me bimët industriale mbillen vetëm një pjesë e vogël nga sipërfaqet e kufizuara. Sot mbillen rreth 6% nga sipërfaqet e kufizuara. Në vendet

agroindustriale kulturat industriale përfshijnë edhe deri më 35% nga sipërfaqet e kufizuara.

Përfaqësimi i llojeve të kulturave industriale të ne është mjaftë e gjerë, por sasia prodhimeve është e pamjaftueshme. Kjo tregon jo vetëm për pamjaftueshmërinë e bujqësisë, por edhe prapambetjen e industrisë në të cilat bimët industriale shërbejnë si lëndë e parë. Në anën tjetër kemi edhe dukurin që industria pjesën e madhe të nevojave të saja ta mbuloi me import ose, për shkak të mungesës së lëndës së parë, kapacitetet të shfrytëzoi vetëm për përqindje të vogël.

Sipas dedikimit dhe përfaqësimit të saj bimët industriale ndahen në: vajdhënëse, të tekstilit dhe bimë të tjera industriale. Nga industria e tekstilit të ne përfaqësohen konopi dhe pambuku. Nga ato vajdhënëse: luledielli, afioni, susami, soja, rrepa vajdhënëse, kikirikët, ricinit, anasonet ndërsa nga bimët tjera industriale: duhani, speci industrial, domatet industriale, panxharsheqeri dhe kulpra.

Duhani. Duhani është njëra kulturat industriale më të përfaqësuara dhe më të rëndësishme ekonomike në Maqedoni. Me origjinë janë nga Amerika. Në Maqedoni konsiderohet se është sjell në vitin 1573, ndërsa fillon në mënyrë të organizuar të prodhohet në vitin 1873 kur edhe është ndërtuar magazina e parë në Prilep.



Terja e duhanit në zonën e Prilepit. Kultivimi i duhanit është punë e mundimshme. Puna e njeriut është e pashmangshëm në të gjitha fazat e prodhimit. Dhe faza e terjes në varg duhet vazhdimisht të mbikëqyret.

Në botë ekzistojnë mbi 70 lloje të duhanit. Në vendin tonë kultivohen tipet vijuese të duhanit: **tipi oriental, gjysmë oriental dhe i virxhinisë.**

Nga tipi oriental në Maqedoni janë përfaqësuar llojet: **prilep, jaka dhe xhebel**, nga llojet gjysmë orientale **holla dhe maja** kurse nga tipi virxhinisë llojet **virxhinia brajt dhe virxhinia klejton.**

Në vitin 2000 me duhan janë mbjellë 22.000 hektarë, nga e cila sipërfaqe janë fituar 22.000 tonë duhan, ose 1.000 kg për hektarë.

Prodhet nëpër gjithë territorin e vendit tonë. Nuk ka komunë ku nuk mbillet. Megjithatë, pjesa më e madhe e prodhimit realizohet në Pellagoni dhe luginën e Strumicës-Radovishit. Në Pellagoni prodhet gati 50% e duhanit, me ç'rast vetëm zona e Prilepit jep 30% nga prodhimi i duhanit dhe ajo është zona kryesore prodhuese.

Në vendin tonë kultivohet numri i madh i bimëve vajdhënëse. Ndërmjet tyre rëndësi kanë: luledielli, afioni, soja, susami, rrepa e vajit, kikirikët dhe bima e ricinit. Pët të gjitha këto është karakteristik se përmbajnë vaj në farën e tyre.

Luledielli. Luledielli është bima jonë më e përhapur dhe më e rëndësishme vajdhënëse. Kultivimi i saj në vendin tonë posaçërisht është i përhapur pas luftës së dytë botërore.




Niveli i lulediellit në Pellagoni. Gjethet e lulediellit janë të pasura me nektar dhe luledielli përveç industrisë së vajit është i shfrytëzueshëm edhe si bimë mjaltë.

Në vitet e fundit mbillen krejtësisht sipërfaqe të vogla me luledielli vetëm rreth 6.000 ha, nga çka ka rezultuar edhe prodhimi i vogël prej rreth 7.000 tonë. Prodhimi i lulediellit kryesisht është i koncentruar me katër zona prodhuese: Pellagonis, Kumanovës, Shkupit dhe Ovçe Poles.

Afioni. Afioni është bimë vajdhënëse dhe e rëndësishme shëruese. Prej tij fitohen dy prodhime - fara dhe cefël. Fara shërben për fitimin e vajit, ndërsa cefla për mbledhjen e morfiumit dhe alkaloidëve të tjera, që janë lënë e parë e kërkuar në industrinë farmaceutike.

Afioni e ka origjinën nga Azia e Vogël, në Maqedoni e sollën Turqit. Prodhimi i afionit te ne është, mjaftë i kufizuar dhe shpesh pëson nga ngrirjet e pranverës. Për shembull, në vitin 2000 ishin mbjell gjithsejtë 490 ha. Megjithatë gjysmën e atyre sipërfaqe ngricat pranverore e zhdukun, ashtu që ai është kultivuar në 200 ha. Në vitet e fundit në mënyrë më masovike kultivohen në zonën e Velesit ku gjenden gati 50% nga sipërfaqet e mbjella.

Bimët e tjera vajdhënëse si: rrepa vajdhënëse, susami, kikirikët dhe tjera kultivohen në sipërfaqe më të vogla.



Ceflat e pjekura të afionit për vjelje. Afioni në të kaluarën ishte kulturë industriale shumë e përhapur në Maqedoni. Me ligjin e vitit 1973 ndalohej prodhimi i opiumit (katranit) me prerjen e ceflave, për shkak të së cilës zvogëlohet pagushmëria ekonomike për kultivimin e tij, ashtu që sot sipërfaqet me afion janë reduktuar në minimum.

Pambuku. Ndërmjet bimëve për fitimin e fijeve, pambuku në botë dhe te ne merr vendin më të rëndësishëm. Në vendet tropikale prej nga e ka origjinën ajo është bimë shumëvjeçare, ndërsa në brezin ton mesdhetar është njëvjeçar. Me qëllim që sa më shumë të lirohemi nga importi i pambukut, kurse edhe zhvillimi i shpejtë i industrisë së tekstilit, në vitet e pasluftës, është krijuar konjuktura e volitshme për prodhimin tonë të pambukut, është formuar Institut i posaçëm për pambukun në Strumicë. Në vitet e shtatëdhjeta pambuk mbillej në sipërfaqe prej 12.000 ha prej të cilave fitohej prej 7 deri në 12.000 tonë pambuk. Megjithatë, importi i lirë i pambukut ka kontribuar edhe ajo konjuktura shpejtë të shuhet, ndërsa sipërfaqet me këtë kulturë të rëndësishme në mënyrë të ndishme të zvogëlohen, kurse viteve të fundit aspak të mos kultivohet.

Panxharsheqeri në Maqedoni paraqite madje në vitin 1950, edhe pse në Evropë ka filluar të kultivohet para 200 vitesh. Ajo është bimë njëvjeçare, që përmban sheqer 18%, kurse më së miri rritet në kushte nxehëtisë mesdhetare, tokës së pjellore dhe me lagështi të lartë.

Në Maqedoni, pas sjelljes së saj më së pari u kultivua në Pellagoni ku janë arritur rendimente të larta, jo shpejtë u përhap edhe në luginat e tjera. Pas ndërimit të Rafinerisë së sheqerit në Manastir në vitin 1961, është krijuar stimulim i fuqishëm stimulues për zhvillimin e mëtutjeshëm të panxharsheqerit te ne.

Piperi industrial. Kultivimi i piperit industrial në Maqedoni veçmas përhapet në vitin 1950 dhe këndej. Në vit mbillen rreth 1000 ha edhe atë në luginat e Strumicës-Radovishit dhe Pellagonisë.